

PRISHTINA



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE 'MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA' SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par.3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.07.2007, merr

## **V E N D I M**

### **PËR PLOTËSIMIN E DISPOZITAVE LIDHUR ME REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES "TOPHANE" NË PRISHTINË**

#### **Neni 1**

Miratohet Vendimi për plotësimin e dispozitave lidhur me realizimin e Planit rregullues "Tophane" në Prishtinë.

#### **Neni 2**

Me qëllim të realizimit të Planit rregullues "Tophane", krahas modelit të konceptit të komosacionit sipas nenit 21 dhe 22 parashihet edhe mundësia e dhënies së lejeve ndërtimore në mënyrë parciale në këtë lagje.

Me këtë Vendim ruhet koncepti urban i lagjes "Tophane" me të gjitha kriteret që i ka përcaktuar plani rregullues, duke nënkuptuar formën e blloqeve urbane, vijat ndërtimore, etazhitetin, pjesët e lira etj.

Me këtë Vendim mundësohet dhënia e lejes në mënyrë parciale sipas ngastrave kadastrale ku përparësi do të kenë ngastrat që shtrihen në tri zona të parapara për ndërtim dhe pjesa tjetër e lire.

Ndërtimi në zonën I mbetet i pandryshuar sipas planit rregullues 100%, në zonën II koeficienti i ndërtimit nga 10% do të rritet në 50%, me etazhitet deri në P+2, derisa në zonën III, ku nuk është paraparë ndërtimi, mund të lejohet përkohësisht vetëm rikonstruktimi dhe plotësimi i kushteve elementare për banim.

Problemi i sigurimit të parkingjeve të nevojshme sipas normave dhe standardeve, duhet të plotësohet, apo mund të propozohet ndonjë lehtësim, duke i paguar taksën Kuvendit të Komunës, i cili merr obligim ndërtimin e garazheve publike.

#### **Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01 Nr. 35-336, më 24.07.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**

**Ismet Beqiri**

